



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVO	
MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË MINISTARSTVO OBRAZOVANJA, NAUKE I TEKNOLOGIJE MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE & TECHNOLOGY SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARHIVE ARCHIVE SECTOR	
Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit	5
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	2
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	3367
Data Datum Date	26.09.2023
Prishtinë + 2	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

Datë: 25-09-2023
Nr. 5/3367

Komisioni për licencimin e BPrAL / kolegjeve private, i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të dispozitave ligjore nga neni 11 paragrafi 3 dhe 4, dhe neni 14 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037 në bazë të neneve 5, 6, 7, dhe 10 të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë, shqyrtoi kërkesën nr. 5, nr. protokolli 3367 të datës 18.09.2023, të parashtruar nga BPrAL- kolegji “HEMERER” për licencimin e programeve sipas vendimit nr. 1209/23 të datës 15.09.2023 dhe mori këtë :

V E N D I M

1. Licencohet Bartësi Privat i Arsimit të Lartë - kolegji “HEMERER” për programet e studimit:
 - 1.1 “Shkencat Shëndetësore për profile diagnostike – Teknik Laborant” (BSc)
 - 1.2 “ Kujdesi Shëndetësor Digjital” (MSc)
 - 1.3 “Psikologji” (BSc)
 - 1.4 “Psikologji klinike” (MSc)
2. Licencimi zgjat për periudhën pesëvjeçare (1 tetor 2023 deri me 30 shtator 2028), sipas vendimit nr. 1209/23 të datës 15.09.2023, të lëshuar nga Agjencioni i Kosovës për Akreditim.
3. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në mbështetje të dispozitave ligjore të cekura më lartë, komisioni për licencim dhe rilicencim të BPrAL/ kolegjeve private i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, pas shqyrtimit të kërkesës nr.5 me nr. protokolli 3367 të datës 18.09.2023, të parashtruar nga kolegji “HEIMERER”, vlerëson se parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet dhe kriteret ligjore për licencim.

Licenca e këtij institucioni privat të arsimit të lartë, zgjat pesë vite akademike (01.09.2023 deri me 30 shtator 2028) sipas vendimit nr. 1209/23 të datës 15.09.2023, i lëshuar nga Agjencioni i Kosovës për Akreditim.

Komisioni për licencim i MASHTI, duke marrë parasysh faktet e këtij institucioni të paraqitura në dokumentacionin e kompletuar ligjërisht për aplikim, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim, mund të parashtrojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi te Sekretari i përgjithshëm i MASHTI-t.

Vendimi u dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës;
2. Komisionit për licencim;
3. Sekretarit të përgjithshëm;
4. DALSHT;
5. Inspektoratit të Arsimit;
6. Arkivit.

Kryetar i Komisionit



Burim Gashi